



SAMITI BE - BALLKANI PERËNDIMOR

Agjenda e liderëve të BE-së, Sofje 2018

SAMITI BE - BALLKANI PERËNDIMOR

Agjenda e liderëve të BE-së, Sofje 2018

Deklarata e Sofjes, 17 maj 2018

Ne, liderët e Bashkimit Evropian (BE) dhe vendet anëtare, në konsultim me partnerët tanë nga vendet e Ballkani Perëndimor, si dhe në prani të palëve relevante rajonale të tanguara, sot jemi dakorduar që:

1. BE-ja përshëndet përkushtimin e përbashkët të partnerëve të Ballkanit Perëndimor, të **vlerave dhe parimeve evropiane**, si dhe vizionit për një Evropë të bashkuar dhe të fuqishme, të përkrahur nga lidhjet tona historike, kulturore dhe gjeografike dhe nga interesat tona të ndërsjella politike, të sigurisë dhe ekonomike.
2. Duke e rikujtuar Samitin e Selanikut të viti 2003, BE-ja konfirmon **mbështetjen e saj të pakursyer për perspektivën evropiane** të Ballkanit Perëndimor. Duke ngritur më tej progresin e arrirë deri më tani, partnerët e Ballkanit Perëndimor konfirmuan angazhimin për perspektivë evropiane si zgjedhje e tyre e fuqishme strategjike, për përforsimin e përpjekjeve të tyre dhe mbështetjes së ndërsjellë. Kredibiliteti i këtyre përpjekjeve varet nga komunikimi i qartë me publikun.
3. BE është e vendosur që ta përforsojë dhe intensifikojë angazhimin e saj në të gjitha nivelet për mbështetje të transformimit politik, ekonomik dhe social në rajon, duke përfshirë edhe ndihmën e shtuar, të bazuar në progres të dukshëm në sundimin e ligjit, si dhe në reformat socio-ekonomike, nga ana e partnerëve të Ballkanit Perëndimor.
4. BE përshëndet përkushtimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për prioritizimin e **demokracisë dhe sundimit të ligjit, posaçërisht luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, qeverisjes së mirë, si dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pjesëtarëve të minoriteteve**. Në këtë bazohet zbatimi

efektiv i reformave të tyre. Shoqëria civile dhe mediat e pavarura luajnë rol kyç në procesin e demokratizimit.

5. BE e mbështet premtimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për të vazhduar me **përforcimin e marrëdhënieve të mira ndër-fqinjësore, stabilitetit rajonal**, dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Kjo konkretisht përfshin gjetje dhe zbatim të zgjidhjeve definitive, gjithëpërfshirëse dhe obliguese, për kontestet e hapura, të cilat janë të rrënjosura në trashëgiminë nga e kaluara, dhe përkushtimin përmes përpjekjeve plotësuese për pajtim.
6. Ndërtimi i rrjetit të dendur të lidhjeve dhe mundësive në rajon dhe me BE-në, është me rëndësi vitale, për përafrimin e qytetarëve tanë dhe ekonomive, si dhe për përmirësimin e stabilitetit politik, prosperitetit ekonomik, zhvillimit kulturor dhe social. Bazuar në progresin e arrirë, duke përfshirë edhe iniciativat rajonale, zotohemi për **ndërlidhje** të rëndësishme në të gjitha dimensionet: transport, energjetikë, digjitale, ekonomike dhe njerëzore.
7. BE pajtohet me mbështetjen e mjedisit të tregut dhe investimeve në Ballkanin Perëndimor, për lëvizje më të shpejtë kah **ekonomia digjitale** dhe kah shoqëri të qëndrueshme dhe **përshtatshme sipas klimës** në pajtim me Marrëveshjen e Parisit. **Siguria energjetike** do të jetë prioritare, duke përfshirë edhe efikasitetin e përmirësuar energjetik, lidhshmëri më të mira ndërkufitare, diversifikim të burimeve dhe kahjeve të gazit, si dhe përzjerje e balancuar energjetike e cila më mirë do ta bashkojë energjinë e ripërtëritshme.
8. Theks i veçantë do të vihet në krijimin e mundësive të reja për të **rinjtë**, njëherit duke u siguruar se kjo do të kontribuon në zhvillimin socio-ekonomik të Ballkanit Perëndimor.
9. Për këtë qëllim BE përshëndet përkushtimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor, mes tjerash, për të përshpejtuar **implementimi i acquis** në kuadër të Marrëveshjeve për shoqëri energjetike dhe shoqëri të transportit, për të mënjanuar të gjitha pengesat administrative të kufijve, për të kompletuar Tregun rajonal të energjisë elektrike dhe për të implementuar urgjentisht Planin aksional nga korrik 2017 për Zhvillim të

fushës rajonale ekonomike. BE do të vazhdojë t'i mbështet këto përpjekje.

10. BE dhe partnerët e Ballkanit Perëndimor ndajnë shumë **sfida sigurie** të cilat kërkojnë përkushtim të koordinuar individual dhe të përbashkët. Kur punojmë së bashku mund t'i zgjidhim me sukses këto sfida. Bashkëpunimi ynë në parandalimin e **flukseve ilegale të migrantëve** tregoi domethënien e saj, dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë të zhvillohet edhe më tej.
11. **Lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit**, duke përfshirë edhe **financimin, radikalizmin dhe** kthimin e **luftëtarëve të huaj terroristë**, kërkon bashkëpunim më të madh.
12. BE dhe partnerët e Ballkanit Perëndimor pranojnë se rezultatet e luftës kundër **korrupsionit dhe krimit të organizuar**, janë me domethënie esenciale për transformimin politik dhe socio-ekonomik të rajonit, si dhe për stabilitetin dhe sigurinë rajonale, të cilat janë me interes parësor për qytetarët e tyre. BE përshëndet zotimin e tyre për të ndërmarr veprime vendimtare, në bashkëpunim me BE-në dhe mes tyre, kundër **trafikimit të qenieve njerëzore, kultivimin e drogës dhe kontrabandës me njerëz drogë dhe armë**.
13. EU përshëndet kontributin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor drejt **Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS)** në të gjitha aspektet e saja dhe pret thellim progresiv të bashkëpunimit në këtë sferë, e posaçërisht nivel të rritur të dakordimit, në veçanti për çështje të cilat kanë të bëjnë me interesa të mëdha të përbashkëta.
14. Ndaj dezinformatave dhe aktiviteteve të tjera hibride, përgjigja do të jetë e përbashkët dhe përmes bashkëpunimit më të madh në **rezistencë, siguri kibernetike dhe komunikim strategjik**.
15. Për të përshpejtuar përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë, në fushat e lidhshmërisë dhe sigurisë, në pikëpamje të perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor, sot, duke marr parasysh aspektet relevante të Komunikimit të Komisionit të sjellë më 6 shkurt të vitit 2018, BE filloi me **Agjendë prioritare të Sofjes** për BE dhe për Ballkanin Perëndimor, e cila është në vazhdim të kësaj deklaratë.

16. BE përshëndet qëllimin e Kroacisë për të qenë mikpritës i Samitit BE – Ballkani Perëndimor në periudhën e kryesimit të tyre në vitin 2020.
17. Konstatohet se partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor dakordohen me pikat e lartpërmendura.

Agjenda prioritare e Sofjes

Përforcimi i mbështetjes për sundim të ligjit dhe qeverisjes së mirë

- Të përforcohet mbështetja në reformat gjyqësore dhe përpjekjet për luftë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve për parandalimin e korrupsionit.
- Të zgjerohen **misionet këshillëdhënëse për sundim të ligjit me** mbështetje të rritur nga vendet anëtare të BE-së.
- Të përforcohet ndjekja e reformave përmes **misioneve** më sistematike **të revizioneve të ekspertëve të bazuar në raste**
- Të sillen **ndjekje e gjykimeve** në fushën e korrupsionit serioz dhe krimit të organizuar.
- Të punohet në matje më të mirë të rezultateve në reformat e gjyqësore.
- Të fillohet me mbështetje të Ballkanit Perëndimor përmes **Fondacionit Evropian për Demokraci** në fushën e mediave të pavarura dhe pluraliste, si dhe shoqërisë civile.

Përforcim të angazhimit për siguri dhe migracion

- Të rritet puna e përbashkët për **luftë kundër terrorizmit** dhe të parandalohet radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, në përputhje me iniciativën për luftë kundër terrorizmit në Ballkanin Perëndimor.
- Të përmirësohet **bashkëpunimi operativ** i rëndësishëm, në luftën kundër **krimit të organizuar** ndërkombëtar në fushat prioritare siç janë: armë zjarri, drogë, kontrabandë të migrantëve dhe trafikim me njerëz.
- Të përgatitet plan aksional i reviduar për bashkëpunim rreth **armëve të zjarrit** për zgjidhje më efektive të mbajtjes ilegale të armës së zjarrit dhe armëve të shumta në dispozicion.
- Të rritet mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike

dhe luftës kundër krimit kompjuterik.

- Të rritet bashkëpunimi në fushën e **migrimit dhe menaxhimit kufitar**.
- Rritje e mëtejshme e bashkëpunimit mes **oficerëve për lidhje** të shpërndarë nga ana e BE-së (Komisioni Evropian dhe Agjencia Evropiane për roje kufitare dhe bregdetare) vendet anëtare dhe autoritetet kompetente të Ballkanit Perëndimor.
- Të krijohet **grup pune ndërmjet agjencive të KQR të BE-së** nga ana e Komisionit.
- Të thellohet dhe zgjerohet bashkëpunimi dhe dialogu për **Politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë / Politikë e përbashkët e sigurisë dhe e mbrojtjes**.
- Të zhvillohet më tej bashkëpunimi në aktivitetet që kanë të bëjnë me **kërcënime hibride**, duke përfshirë edhe përmirësimin e komunikimit strategjik.

Mbështetje e zhvillimit socio-ekonomik dhe vendosje e fokusit të veçantë tek të rinjtë

- Të zgjerohet **Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor** për tërheqje dhe koordinim të mëtejshëm të donatorëve bilateral dhe institucioneve ndërkombëtare investuese.
- Të përforcohet në mënyrë të konsiderueshme Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor si **garancë** për tërheqjen e investimeve private.
- Të rritet mbështetja e arsimit, posaçërisht të fillojë pilot projekt për mobilitet në **arsimin dhe trajnimin profesional**.
- Të dyfishohen mjetet për **Erazmus+** për rajonin, duke përfshirë edhe vendosjen e **“Labororit për të rinj të Ballkanit perëndimor”** në vitin 2018, duke siguruar hapësirë për krijimin e politikave inovative për nevojat e të rinjve dhe ballafaqimin me largimin e trurit (brain drain).
- Të zgjerohet fushëveprimi dhe përfshirja e **Zyrës rajonale për bashkëpunim rinor** dhe të silltet skemë intrea-rajonale për mobilitet.
- Të sigurohet progres në implementimin e Fushës rajonale ekonomike, duke përfshirë edhe përforcimin e punës për praninë të kualifikimeve dhe progresit për lehtësim të tregtisë në Ballkanin Perëndimor.

- Progres të Bosnjës dhe Hercegovinës në proceset e aderimit në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Rritje e lidhshmërisë

- Të fillojë **pako e re e projekteve për lidhshmëri** (me grante të rëndësishme të BE-së si ndihmë) përmes Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe ndihmën për “Autostradën e kaltër” dhe “Autostradën e paqes” (Nish-Prishtinë)
- Te mbështetet shfrytëzimi i rritur i mundësive nën dispozitat aktuale të **Instrumentit për lidhshmëri të Evropës** në Ballkanin Perëndimor
- Të zgjerohet **Unioni Energjetik i BE-së** në Ballkanin Perëndimor, duke u fokusuar në sigurinë dhe doverzifikimin e burimeve dhe furnizuesve, përfshirë edhe strategjinë në nivel rajonal e cila do të kishte përfitime nga burimet ripërtëritëse, posaçërisht të hidro-energjisë
- Të punohet në drejtim të përfundimit të **Tregut rajonal të energjisë elektrike** në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurohet që e njëjta të inkorporohet në Tregun e brendshëm të energjisë elektrike të BE-së, mes tjerash edhe përmes iniciativës për Lidhshmëri të Evropës Qendrore dhe Juglindore (CESEC)
- Në mënyrë plotësuese të mbështetet krijimi i hapësirës së vetme rregullatore dhe i procesit efektiv të reformave në tregun energjetik në pajtueshmëri me **Marrëveshjen për komunitet energjetik**
- Të nënshkruhet Memorandum/zotim për mirëkuptim për interkoneksionin e gazit Bulgari/Serbi
- Të fillohet me implementimin e Marrëveshjes për komunitet të transportit dhe funksionalitet të plotë të sekretariatit të tij
- Të nënshkruhet marrëveshja mbi Selinë e Traktatit të komunitetit të transportit (Beograd)
- Të miratohet Deklarata ministrore për transport prej Ditëve TEN-T e Ljubljanes, përfshirë këtu edhe planin aksional të listës për kalime kufitare prioritare

- Të miratohet Deklarata ministrore për transport lidhur me sigurinë e rrugëve prej Ditëve TEN-T të Ljubljanës dhe plani aksional
- Të mbështetet strategjia e re e hekurudhës për ndërlidhje me Ballkanin Perëndimor dhe BE-në, si dhe vendosja e saj në tregun e BE-së.

Agjenda digjitale e Ballkanit Perëndimor

- Të fillojë **Agjenda digjitale e Ballkanit Perëndimor**, duke përfshirë edhe udhërrëfyesin për lehtësim të uljes së shpenzimeve për roaming
- Të fillojë një pako e konsiderueshme e ndihmës teknike për identifikim të **investimeve të mundshme digjitale** (duke përfshirë edhe internetin me përfshirje të gjerë) përmes Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor/Instrumentit për ndihmë para-aderuese

Mbështetje e pajtimit dhe e marrëdhënieve të mira fqinjësore të Ballkanit Perëndimor

- Të mbështetet **lufta kundër mosndëshkimit** përmes mbështetjes së Mekanizmit për Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe të Odave të posaçme të Kosovës* përmes EULEKS-it
- Të hapet dritare në **Programin Evropë Kreative** të BE-së
- Të promovohet thellimi i lidhjeve mes shoqërive civile të Ballkanit Perëndimor, gjithashtu edhe përmes mbështetjes së projekteve të Fondit për Ballkan Perëndimor.

Kjo agjendë prioritare do të implementohet në mënyrë neutrale të statusit dhe pa qenë në kundërshtim me diskutimet për kornizën financiare shumëvjeçare

* Ky shënim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit për siguri të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës